



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeća na Kosovu
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency

**PËRGJIGJE PËR PYETJET MË TË SHPESHTA NË LIDHJE ME THIRRJEN PUBLIKE
PËR GRANT SKEMËN PËR ENERGJI TË PASTËR**

1. Cili është dokumenti bazë që vërteton ekzistencën ligjore të ndërmarrjes? **Përgjigje:** Certifikata e regjistrimit të ndërmarrjes me të gjitha informatat përcjellëse sipas legjislacionit në fuqi
2. A lejohet aplikimi për subvencionim në rastet kur njëhsoni dhe faturimi i energjisë elektrike nuk janë në emër të kompanisë aplikuese, por kryhen përmes një pale të tretë.
Përgjigje: Për t'u kualifikuar për grant, biznesi aplikues i cili ka veprimtari parësore ose dytësore në prodhim apo përpunim duhet të ketë njëhsonin e energjisë elektrike të regjistruar në emër të tij.
3. Kompanitë prodhuese të cilat kanë përfutur grant nga MINT/KIESA dhe LuxDev për makineri prodhuese në vitin 2024, a kanë të drejtë aplikimi për këtë skemë të granteve për instalimin e sistemeve solare fotovoltaike?
Përgjigje: Lejohet aplikimi në grant skemën për energji të ripërtëritshme.
4. Në shtojcën inverter me frekuencë të ndryshme – formulari Teknik po kërkohet Intervali i Fuqisë, cka nënkupton kjo?
Përgjigje: Tek intervali i fuqisë duhet të specifikohet fuqia e pajisjeve ekzistuese për të cilat aplikohet për shndërrues të energjisë.
5. Pyetje për inverter me frekuencë të ndryshme: Tek pjesa ku shkruan financuar nga granti thuhet që financohen 70% e vlerës së pajisjes dhe deri në 65 € /kW. Investimi jonë i planifikuar për disa inverter është mes 30000-35000 €, a do të thotë kjo se nëse investimi është 35000 € atëherë 70% është 24500 € (granti financohet me maksimum 20000 €) dhe a do të thotë që granti mbulon deri në 65 € /kW që do të thotë 20000 €/65 €per kw = 308 kW?
Përgjigje: Granti mbulon 70% të vlerës totale të pajisjes, por jo më shumë se 65 euro/kW dhe deri në shumën maksimale prej 20,000 euro. Kjo nënkupton se të tre limitet zbatohen dhe vlera totale e grantit do të jetë më e ulët ndër këto tre vlera. Një shembull sa për sqarim: nëse investimi total është 35,000 euro, atëherë 70% = 24,500 euro, mirëpo granti nuk mund të tejkalojë 20,000 euro. Gjithashtu, për të përfutur

shumën e plotë prej 20,000 euro, kapaciteti i pajisjes duhet të jetë të paktën 308 kW ($20,000 / 65 = 308 \text{ kW}$). Nëse kapaciteti është më i vogël, atëherë përlllogaritja do të bëhet sipas formulës: $65 \text{ euro} \times \text{kapaciteti (kW)}$, duke respektuar gjithmonë kufirin prej 20,000 euro dhe 70% të vlerës totale të pajisjes.

6. Në rast se një biznes ka të instaluar paraprakisht 81 kW sistem solar të pranuar teknikisht nga KEDS dhe dëshiron të shtojë edhe 100 kW të tjerë, ku pëlqimi elektroenergjetik për të dy sistemet është 100 kW nga KEDS, për cilin kapacitet duhet të aplikohet për subvencionim në kuadër të Masës 1: vetëm për kapacitetin e ri prej 100 kW, apo për 19 kW që i jep shtesë me pëlqimin e ri elektroenergjetik?

Përgjigje: Në kuadër të Masës 1, pranohen për subvencionim sistemet e reja, përkatësisht kapaciteti shtesë i instaluar, dhe jo kapaciteti ekzistues që është instaluar më herët. Në rastin konkret, aplikimi për subvencionim mund të bëhet vetëm për kapacitetin e ri.

7. Në rast se një biznes ka pëlqim elektroenergjetik për instalim të sistemit solar prej 3 kW, a ekziston ndonjë kufizim lidhur me kapacitetin maksimal të baterive për të cilat mund të aplikohet për subvencionim?

Përgjigje: Sa i përket instalimit të baterive, nuk përcaktohet një limit për kapacitetin maksimal të tyre në kuadër të skemës së subvencionimit. Mirëpo, dimensionimi i baterive duhet të jetë në përputhje të plotë me kornizën ligjore në fuqi. Sistemi i baterive duhet të jetë në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-258 për Burimet e Energjisë së Ripërtërishme, konkretisht Neni 28, paragrafi 2.2.1–2.2.2, që përcakton se

- sistemi i baterive mund të mbushet me energji elektrike vetëm nga stabilimenti për vet-prodhim me burime të ripërtërishme (sistem solar FV);
- çdo mbushje e baterive nga rrjeti elektrik është e ndaluar dhe konsiderohet përdorim i paautorizuar i energjisë elektrike.

8. A mund të aplikojë një biznes për grant për sistemet e baterive për secilin lokacion veçmas, nëse operon në disa lokacione nën të njëjtin numër unik/fiskal të biznesit?

Përgjigje: Aplikimi dhe përfitimi i grantit bëhet në nivel të aplikuesit.

Në përputhje me kriteret e Masës 1, për secilën nën-masë lejohet përfitimi vetëm për një (1) sistem për aplikues, pavarësisht nëse kompania operon në disa lokacione të ndryshme.

9. Në ora sa mbyllet thirrja për aplikim për fazën 1 (përfshirë orën)?

Përgjigje: Thirrja publike mbyllet më datë 31.01.2026, në ora 23:59.

10. A mund të përfitojë grant një biznes prodhues për një sistem solar fotovoltaiik që është blerë dhe instaluar para shpalljes së thirrjes publike?

Përgjigje: Sipas thirrjes publike për përkrahjen e bizneseve prodhuese, për masën për mbështetje të sistemeve solare fotovoltaike (Masa 1), pranohet fatura dhe dëshmia e pagesës nga data 15 shtator 2025 e tutje.

11. A mund të aplikojnë bizneset që kanë të instaluar sistem solar fotovoltaiik para datës 10.09.2025 për subvencion për sistemet e baterive?

Përgjigje: Po mundet. Sipas thirrjes publike, lejohet aplikimi për subvencion për sistemet e baterive për ruajtjen e energjisë elektrike edhe për aplikuesit që kanë të instaluar paraprakisht një sistem solar fotovoltaiik, qoftë prapa njehsorit (behind the meter), ose në përputhje me rregullën për vet-konsumatorët (prosumatorët) sipas legjislacionit në fuqi.

12. Sa është kufizimi për kapacitetin (kWh) e baterive për të cilat mund të aplikohet?

Përgjigje: Thirrja nuk përcakton një kufizim të drejtpërdrejtë në kWh për kapacitetin e baterive. Mbështetja financiare për sistemet e baterive është e përcaktuar si vijon:

- 130 €/kW, duke përfshirë kostot e instalimit, dhe deri në vlerën maksimale prej 20,000 €
- sistemi i baterive duhet të jetë në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-258 për Burimet e Energjisë së Ripërtërishme (Neni 28, paragrafi 2.2.1–2.2.2), që do të thotë se mund të mbushet me energji elektrike vetëm nga stabilimenti për vet-prodhim me burime të Ripërtërishme (sistem solar FV) dhe jo nga rrjeti elektrik.

13. A lejohet aplikimi për grant për sistemet e baterive kur aplikimi parasheh një kapacitet të caktuar të instaluar të baterisë (p.sh. 100 kW), dhe a ekziston ndonjë kufizim i kapacitetit?

Përgjigje: Subvencionimi vlen për të gjithë kapacitetin e instaluar të sistemit të baterive, sipas konfigurimit teknik të paraqitur në aplikim (p.sh. 100 kW) duke zbatuar kufizimin vetëm në vlerën e mbështetjes financiare (130 euro/kW dhe deri në 20,000 euro), në përputhje me kushtet e Thirrjes, dhe sistemi duhet të jetë në përputhje me Ligjin për Burimet e Energjisë së Ripërtërishme (BRE).